

# **NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. MANJOLA KAJANA**

06/19/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 18.06.2019 për subjektin e rivlerësimit, znj. Manjola Kajana, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 19.06.2019 vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Manjola Kajana, prokurore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga z. Olsi Komici , znj. Brunilda Bekteshi relatores, z. Lulzim Hamitaj anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.